

**UNIVERSITETI I EJL
JHE YHИBEP3ИTET
SEE UNIVERSITY**

FAKULTETI I SHKENCAVE DHE TEKNOLOGJIVE BASHKEKOHORE

PUNIMI I MAGJISTRATURËS

**Faktorët që ndikojne në rënien e suksesit në tranzicionin nga shkolla fillore në
shkollë të mesme**

Rast studimi: Shkollat e Komunës se Lipjanit

Kandidatja

Edita Selmani

Mentori

Prof.Dr.Jaumin Ajdari

Tetor, Tetovë, 2019

DEKLARATA E AUTORIT

Unë, **Edita Selmani**, studente në Fakultetin e Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore në Universitetin e Europës Juglindore (SEEU) “Deklaroj se une jam autori origjinal i këtij punimi”.

Edita Selmani

ABSTRAKTI

Qëllimi i këtij hulumtimi është gjetja e faktorëve që ndikojnë në rënien e suksesit gjatë tranzicionit prej shkollës fillore në shkollë të mesme- rast studimi Komuna e Lipjanit, Kosovë. Në këtë studim ne kemi hulumtuar përceptimet e nxënësve në shkollë fillore dhe shkollë të mesme në mënyrë që të sigurojme sqarime rreth faktorëve që ndikojnë në suksesin e nxënësve. Arsimi është e drejte primare e çdo individi, pasi që siguron aftësi dhe dituri individuale në mënyrë që njerëzit të kemi jetë më të mirë, arsimi është pasuria më e madhe dhe zhvillimi më i duhur ekonomik i shoqërisë. Gjithashtu, ky studim do të paraqes rezultate të pasura pasi që janë mbledhur të dhëna nga nxënësit, dhe mësuesit në Komunën e Lipjanit. Rezultatet e këtij studimi janë të rëndësishme për identifikimin e faktorëve që ndikojnë në rënien e suksesit gjatë tranzicionit prej shkollës fillore në shkollë të mesme. Ky studim do të analizoj të dhënat e suksesit gjatë fazës 2013-2017 në Komunën e Lipjanit, dhe do të identifikohën faktorët që ndikojnë në rënien e suksesit gjatë tranzicionit prej shkollës fillore në shkollë të mesme.

Fjalët Kyçe: Faktor, rënie, tranzicion, shkollë, nxënës, mësues.

ABSTRACT

The main aim of this study is identifying factors affecting the decline in success in transition from elementary school to high school- case study: Schools at the Municipality of Lipjan. In this study, we have identified students' perceptions during primary school and high school in order to find out factors that decline their success. Education is a fundamental right for every person, since it provides individual knowledge in order to have a better life tomorrow. Through education we can develop our society as well as our life. This study will identify results gathered from students and professors at School in the Municipality of Lipjan. The results of this study are important in identifying factors that affect the decline of students' success during transition from primary school to secondary school. This study will analyze the data from 2013-2017 in the Municipality of Lipjan, and we will identify the factors that affect the decline of students' success during transition from primary school to secondary school.

Keywords: Factors, decline, transition, schools, students.

Përmbajtje

DEKLARATA E AUTORIT	2
ABSTRAKTI.....	3
ABSTRACT	4
Kapitulli 1	7
1. Hyrje	7
1.1.QËLLIMET E HULUMTIMIT	9
1.2. HIPOTEZAT	10
1.3. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	11
1.4. INSTRUMENTI.....	12
1.5. PROCEDURA	12
1.6. TË DHËNAT	12
Kapitulli 2	13
2.Rishikimi i Literatures.....	13
KAPITULLI 3	20
3.1. Analiza e suksesit të marrur nga Drejtoria e Arsimit në Komunën e Lipjanit.....	20
3.1.1. Krahasimet dhe rezultatet e suksesit.....	25
3.2. Mënyra, forma dhe metodologjia e anketimit	28
3.3. Analiza e anketimit të nxënësve	30
3.4. Analiza e anketimit të mësimeve	52
3.5. Diskutimet dhe Rezultatet me nxënësit	64
3.5.1. Diskutimet dhe Rezultatet me mësimeve	66
KAPITULLI 4	69

4.1. Përfundimi.....	69
REFERENCAT	72
Shtojca 1: Pyetesor	74
Shtojca 2: Pyetesor	78

Kapitulli 1

1. Hyrje

Arsimimi nuk është përgatitje për jete, Arsimim është vete jeta”

Xhon Djui (Edu-sofia.blogspot.com, 2013)

Arsimi është një element shumë i rëndësishëm në jetën shoqërore dhe është proces i tillë në të cilin të vjetrit ndikojnë në mënyrë të vetdijshme në brezat e rinj duke ia botuar aftësite, përvojat e veta. Arsimi është faktor shumë i rëndësishëm në personalitetin e qdo njeriu. Me fjalën edukatë në kuptim më të ngushtë kuptohet zhvillimi i fuqisë dhe aftësive të brezave të ri siq është aftësimi mendor, fizik, estetik, moral etj, kurse me fjalën edukatë në kuptim më të gjerë kemi të bëjmë tëresinë e ndikimeve pedagogjike që synojnë formimin e një individi. Nuk ka prindër që nuk do të donin që fëmija i tyre të ishte shembull për të tjerët si në edukim, sjellje apo kulturë. Faktori edukues është një nga funksionet dhe elementet më të rëndësishme që debatohet më së shumti në shoqëri dhe ditëve të sotme. Ky funksion gjen zbatim të gjerë edhe në jetën e përditshme. Për edukim të drejtë të fëmijës dhe për formim të një personaliteti të shëndoshë, faktor kryesor është roli i prindërve. Prindërit gjithashtu kanë një rëndësi të madhe jo vetëm në edukimin e fëmijës por edhe në zhvillimin, shoqërimin, dhe vetëbesimin e fëmijëve. Ngrohtësia dhe qëndrueshmëria e marrëdhënieve në familje, sjellja e prindërve dhe bashkëpunimi me nxënësit, kujdesi ndaj tyre, angazhimi dhe koha e përkushtimit ndaj tyre ndikon në mënyrë të sigurt në formimin e një personaliteti të shëndoshë në të ardhmen e tyre. Faktori edukues është një faktor i pazëvendësueshëm dhe i pakthyeshëm, pasi që nxënësi merr bazën e personalitetit qysh nga familja. Nxënësi nuk lind i ditur, por ai së pari orientohet nga prindërit, anëtarët e familjes pastaj gradualisht nga të afërmit, nga fqinjët, dhe me tranzicionin e kohës edhe nga mjedisi më i gjerë. Andaj, shkolla është vatrë e dytë e edukimit pas familjes, prindërit duhet të dëgjojnë se çfarë kanë mësuar nxënësit në shkollë, dhe gjithashtu të shprehin vullnetin e tyre dhe tju ndihmojnë fëmijëve, pasi që shkolla ka vlera dhe parime pozitive që janë themel i shoqërisë. Puna e mësimeve në shkollë është të ngulite thelle parimet e të qenët njeri dhe qytetar i suksesshëm. Pasi që dihet se edhe shoqëria nuk mund të

përparojë nëse nuk ekziston një edukim cilësor i anëtarëve të saj, sidomos nga ndikimi i mësimdhënësve. Gjendja e njerezimit na bënë që të shohim se edukimi është institucioni më i rëndësishëm midis të gjithë institucioneve. Por, dihet që nxënësi qysh në fazën e hershme kalon nëpër ndryshimeve të shpejta si në aspektin individual po ashtu edhe në aspektin shkollor. Disa nxënës nuk kanë probleme gjatë tranzicionit prej shkollës fillore në shkollë të mesme pa ndonjë stres dhe pa probleme serioze, kurse për disa nxënës të tjerë, për fat të keq fillon stresi pasi që nuk dinë se cili drejtim është me të duhur, duke pyetur prindër, anëtar tjerë të familjes, shok/shoqe, mësimdhënës të shkollës fillore, apo mësimdhënës të shkollës së mesme. Shumica e nxënësve kalojnë nëpër këto faza gjatë fazës shkollore në jetën e tyre, këto faza janë:

Hyrja në shkollë fillore, fillimi i shkollës, ndryshimi i vitit prej një klase në klasën tjetër, ndryshimi prej një shkollë në shkollën tjetër, tranzicioni prej shkollës fillore në shkollë të mesme, si dhe prej shkolles së mesme në edukim të mëtutjeshëm. Por, ne kemi qëllim kryesor tranzicionin nga shkolla fillore në shkollën e mesme, kur nxënësit e kalojnë ndryshimin prej një klase në klasën më lartë ose në mes të shkollave, ata duhet të pajtohen me rrethanat, duke u njohur me shokët, dhe me mësimdhënësit e rinj. Përderisa nxënësit zhvillohen në ambientin e ri shkollor, ata duhet t'i përshtatën edhe ndryshime shoqërore përderisa e ndryshojnë shkollën dhe klasën. Tranzicioni nga shkolla fillore në shkollën e mesme lidhet me ndryshimet shoqërore, emocionale, dhe psikologjike në jetën e nxënësve. Ky punim ka rëndësi të veçantë në:

Faktorët e rënies së suksesit të nxënësve, në mënyrë që ne si mësimdhënës/e të angazhohemi, të adresohemi në mënyrë proaktive, duke zhvilluar progres akademik e të motivojmë nxënësit për mësimnxënie dhe rritje të cilësisë. Rëndësia e këtij punimi është të shfaqë dhe mbështesë nxënësit gjatë gjithë vitit e jo vetëm gjatë fillimit të vitit, por edhe të sigurojë mbështetje standarde etike dhe leadership që ndërton kulturën e një shkolle gjithëpërfshirëse, në reduktimin e rënies së suksesit.

Ky hulumtim është ngritur mbi bazën e pyetjeve të mëposhtme:

1. A kanë shkollat fillore dhe të mesme plan dinamik për ngritjen e suksesit të këtyre nxënësve?
2. Cilët faktorë ndikojnë në rënien e suksesit gjatë tranzicionit nga shkolla fillore në shkollë të mesme?

3.Si e përceptojnë nxënësit tranzicionin nga shkolla fillore në shkollë të mesme?

1.1.QËLLIMET E HULUMTIMIT

Qëllimi i këtij studimi është të shfaqë faktorët që ndikojnë në rënien e suksesit gjatë tranzicionit prej shkollës fillore në shkollë të mesme-rast studimi komuna e Lipjanit. Arsyeja kryesore që vendosem të punojmë në këtë studim është gjetja e faktoreëve që ndikojnë në rënien e suksesit gjatë tri viteve, periudha 2013-2014 e deri në periudhën 2016-2017, pasi që dihet se arsimi është pjesa më e rëndësishme për secilin individ, dhe baza e çdo shoqërie. Studimi i faktorëve që ndikojnë në rënien e suksesit konsiderohet mjaft i rëndësishëm, pasi që nëse dihen faktorët e rënies së suksesit, mund të mirren masa parandaluese dhe në vend të rënies të kemi ngritje dhe cilesi në mësimdhënie dhe mësimnxënie.Faza e tranzicionit prej shkollës fillore në shkollë të mesme mund të ndikojë negativisht në performancë akademike të nxënësve, andaj studimi i këtij punimi ka për qëllim hulumtimin e ndryshimeve dhe përshkrimin e faktoreve që ndikojnë gjatë tranzicionit prej shkollë fillore në shkollë të mesme. Arsimimi është faktori kryesor në jetën e nxënësve dhe në zhvillimin e personalitetit si dhe ndihmon në qëndrueshmërinë e tërë shoqërisë. Tranzicioni prej shkolles fillore në të mesmën është qështje delikate për nxënësit, por faktorë kryesor në sigurimin e rezultateve më të mira të nxënësve është vet shkolla dhe ambienti shkollor. Nxënësit hyjnë në shkollë të mesme me një dëshirë për rritje për autonomi dhe vetëvendosje dhe një aftësi më të madhe për të përdorur strategji njohëse të nivelit më të lartë. Nxënësit në këtë fazë i konsiderojnë marrëdhëniet ndërmjet bashkëmoshatarëve me një rëndësi të veçantë, gjithashtu nxënësit konsiderojnë nevojën për diskutim edhe më të rritur, megjithatë nxënësit e hershëm shpesh ballafaqohen me ndryshime regressive në mjedisin shkollor. Përvojat e nxënësve në shkollën e mesme mund të jenë rezultat i faktoreve siq është përvoja e tyre e kaluar në shkollën fillore, pritjet për shkollën e mesme dhe një varg aspektesh të studimit shkollor. Andaj qëllim kryesor i këtij studimi është:

Hulumtimi i faktorëve, që ndikojnë në tranzicionin e nxënësve nga shkollat fillore në shkollat e mesme në komunën e Lipjanit, në Kosovë.Sigurimi më i mirë i cilësive në mësimdhënie duke i ndihmuar nxënësit të zgjerojnë njohuritë e tyre dhe të kenë aftësi gjatë mësimnxënies.

Ky studim ka për qëllim edhe fuqizimin e nxënësve në mësimnxenie duke i dhënë atyre mbështetje në mënyre që të mos kenë rënie në suksesin e tyre.

Gjithashtu, ky studim ka për qëllim të përcaktoj lidhjen në mes të sistemit edukues të prinderve si dhe tranzicionit të studenteve nga shkolla fillore në shkollë të mesme.

Teza do të organizohet në katër kapituj me përmbajtje si në vijim:

Kapitulli i parë do të përfshijë një hyrje mbi rëndësinë e shkollimit.

Kapitulli I i dytë do të përfshijë rishikimin e literatures dhe analizen e faktoreve të cilët ndikojnë në fazën e tranzicionit prej shkolles fillore në shkollë të mesme.

Në kapitullin e tretë do të analizohen sukseset e nxënësve të shkollës fillore dhe të mesme gjatë periudhës trevjeqare 2013-2017 në komunën e Lipjanit, Kosove si dhe do të paraqesim rezultatet e rastit studimor me mësimdhënësit dhe nxënësit e shkollave të mesme në Komunën e Lipjanit.

Kapitulli I katërt do të përfshijë perfundimin e këtij punimi.

1.2. HIPOTEZAT

Në kuadër të këtij punimi, konform realizimit të hulumtimit do të jenë të adresuara hipotezat vijuese:

H1: Bashkëpunimi i vazhdueshëm i nxënësit, prinderit dhe mësimdhënësit sigurojnë një kalim të suksesshëm nga shkolla fillore në shkollë të mesme.

H2: Në përgjithësi faktorët kryesor për tranzicionin e suksesshëm nga shkolla fillore në shkollën e mesme janë gjendja emocionale, gjendja sociale, niveli arsimor i prinderve dhe suksesi në çdo fundvit.

H3: Ndryshimi i ambientit shkollor, dhe mjedisit shoqëror ndikon gjatë tranzicionit të nxënësve prej shkollës fillore në shkollë të mesme.

Në lidhje me hipotezën H1 do të bëhet një analizë e detajuar individuale e nxënësve dhe mësimdhënësve për një bashkëpunim të vazhdueshëm, për të arritur një kalim të suksesshëm

nga shkolla fillore në shkolle të mesme. Nga rezultatet e nxjerrura do të konkludojmë mbi vërtetësinë e hipotezës.

Për të vërtetuar hipotezën H2 do të bëjmë një hulumtim në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme në komunën e Lipjanit, cilët faktorë kryesor ndikojnë në rënien e suksesit të nxënësve?

Për të vërtetuar hipotezën H3 do të përdoren rezultatet e hulumtimeve shkencore për të konkluduar se si ndikon ndryshimi i ambientit shkollor dhe mjedisi shoqëror gjatë tranzicionit të shkollës fillore në shkollë të mesme.

1.3. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Në mënyrë që të kryhet ky studim kemi përdorur metodologji të ndryshme në mënyrë që të përfitojmë përgjigjet nga pyetësit të cilët janë krijuar special për këtë qëllim siq është gjetja e faktorëve që ndikojnë në rënien e suksesit gjatë tranzicionit prej shkollës fillore në shkollë të mesme-rast studimi Komuna e Lipjanit.

Për realizimin e këtij hulumtimi, do të përdoren këto metoda:

- Metoda empirike – kjo metodë kryesisht do të përdoret për të identifikuar aspektet kuantitative të gjendjes faktike në lidhje me çështjen në fjalë.
- Metodën statistike – Do të bëhet një anketim me nxënës dhe mesimdhësit dhe do të mbledhen të dhënat nga pyetësit e krijuar për qëllim të temës.
- Metoda e induksionit dhe e deduksionit – kjo metodë kryesisht do të përdoret për sjelljen e konkluzioneve dhe dhënien e rekomandimeve në lidhje me temën e shtruar. Gjithnjë duke filluar prej të dhënave të grumbulluara, analizën e faktorëve signifikantë si dhe varësinë në mes variablave të ndryshme.
- Metoda komparative – do të shfrytëzohet për të gjitha krahasimet e nevojshme për këtë hulumtim.
- Metoda analitike - do të përdoret për analizën e rezultateve të fituara si dhe sjelljen e konkluzioneve dhe rekomandimeve në bazë të atyre rezultateve.

1.4. INSTRUMENTI

Ky është një studim transversal ku si instrument për mbledhjen e të dhënave kemi përdorur pyetësorët me nxenesit dhe mesimdhënesit e shkollave të mesme në komunën e Lipjanit me pyetje të standardizuara në lidhje me këtë punim. Me anë të metodës sasiore të grumbullimit të të dhënave nga përgjigjet e fituara prej pyetësorëve të përpiluar special për këtë qëllim, përshkruhen dhe analizohen pyetësorët në mënyrë për të pasur një pasqyrë të qartë lidhur me faktorët që ndikojnë në rënien e suksesit gjatë tranzicionit prej shkolles fillore në shkollë të mesme. Si instrument është përdorur formati i shkalles së katërtë të Likertit në vlerësimin e përgjigjeve të nxënësve dhe mesimdhënësve. (Plotesisht nuk pajtohem, nuk pajtohem, pajtohem, plotësisht pajtohem).

1.5. PROCEDURA

Popullimi I këtij studimit përbëhet nga nxënësit dhe mesimdhënësit e shkollave të mesme në komunën e Lipjanit. Gjatë këtij hulumtimit janë anketuar, respektivisht kemi përdorur një mostër prej 100 nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme në komunën e Lipjanit në lidhje me faktorët që ndikojnë në rënien e suksesit gjatë tranzicionit prej shkolles fillore në shkollë të mesme për periudhën kohore 2013/2014-2016-2017.

1.6. TË DHËNAT

Në pyetësorin e formuar lidhur me faktorët që ndikojnë në rënien e suksesit gjatë tranzicionit prej shkolles fillore në shkollë të mesme marrin pjesë gjithsej 100 nxënës nga shkollat e mesme në komunën e Lipjanit, si dhe 50 mesimdhënes, gjithsej njëqind e pesëdhjetë (150) pjesëmarrës. Te dhenat e grumbulluara të anketimit i ruajmë në Google Drive.

Kapitulli 2

2.Rishikimi i Literatures

“Tranzicioni prej shkollës fillore në shkollë të mesme theksohet si lëvizje nga një rrethanë në tjetrën me ndryshime të ambientit, sjelljeve, përditshmërive dhe pritjeve”.

(Departamenti i Arsimit dhe Zhvillimi të nxënësve në shkollë të mesme,2014)

Duke u bazuar në Departamentin e arsimit dhe zhvillimit të nxënësve (Education, 2014) në Melbourne të Australisë i cili konstaton se: për fëmijët dhe nxënësit, roli i tranzicionit prej shkollës fillore në shkollë të mesme është lëvizje e ndryshimeve dhe disa nxënës mund të përshtaten kurse për disa nxënës nevojitet përkrahje gjatë kësaj faze të tranzicionit. Përkrahja e nxënësve gjatë tranzicionit prej shkollës fillore në shkollë të mesme kërkon kohë dhe mbikqyrje fizike për shkak të lëvizjes prej një shkolle në shkollën tjetër. Përkrahja gjatë tranzicionit tek nxënësit mund të ketë sukses nëse nxënësit kanë përkrahje prindërvë dhe të mësimdhënësve në mënyrë që nxënësve t’ju sigurohet tranzicioni i suksesshëm nga shkolla fillore në shkollë të mesme. Gjithashtu autorët e njohur (Sharon Cox, Shelley Kennedy, 2008) në librin e quajtur “Arritjet e nxënësve gjatë fazes së tranzicionit prej shkolles fillore në shkollë të mesme” në Zelandën e re theksuan se : nxënësit dhe njerëzit e rinjë kalojnë nëpër faza të ndryshme gjatë jetës së tyre. Nxënësit gjatë kësaj periudhe kalojnë prej një klase në klasën tjetër, ose prej një shkollë në shkollën me nivel më të lartë, por fokusimi kryesor është tranzicioni prej shkolles fillore në shkollë të mesme, veqanërisht faktorët që ndikojnë në rënien e suksesit gjatë tranzicionit të kësaj faze. Faza e tranzicionit prej shkollës fillore në shkollë të mesme është tejet sfiduese pasi që paraqet për nxënësit sfida të ndryshme si përshtatja në ambientin e ri shkollor, rregullat e reja, detyrat shkollore të punës, mësimdhënësit dhe shokët e rinjë. Tranzicioni prej shkollës fillore në shkollë të mesme është tejet sfidues në jetën e nxënësve, pasi që gjatë kësaj faze të tranzicionit dhe këtyre ndryshimeve nxënësit formohen si personalitet dhe natyrisht avansohen në karrierën gjatë jetës së tyre. Autorët e njohur (Dr. Kate

Tillczek & Dr. Bruce Ferguson, 2007) në librin e quajtur “Tranzicioni dhe shtigjet nga shkolla fillore në shkollë të mesme” në Kanada theksuan se: Tranzicioni prej shkolles fillore në shkollë të mesme është proces i zhvillimit të përkohëshëm i cili kalon nëpër shoqëri, akademi, dhe vazhdon tutje me një mori organizative në mënyrë që të kategorizohen strategjitë e tranzicionit prej shkolles fillore në shkollë të mesme. Periudhat e tranzicionit prej shkolles fillore në shkollë të mesme mund të rrisin rrezikun për nxënësit, kemi nxënës që kalojnë nëpër faktore negativ në shtëpi, në shkollë, dhe në lagje dhe këta faktore së bashku mund të ndikojnë në rënien e suksesit gjatë tranzicionit prej shkolles fillore në shkollë të mesme.

Grupi i autorëve (Zeedyk, M. S., Gallacher, J., Henderson, M., Hope, G., Husband, B., & Lindsay, K., 2003) në revistën shkencore *School Psychology International*, 24(1), 67–79 me titullin “Përceptimet e nxënësve, prindërve dhe mësimeve” theksuan se: Tranzicioni arsimor prej shkollës fillore në shkollë të mesme është një nga sfidat më të mëdha tek nxënësit, dhe si i tillë mund të ketë ndikim negativ në mirëqenien dhe arritjet akademike të nxënësve.

Autori (Sirsch, U., 2003) në revistën shkencore të titulluar “Tranzicioni prej shkolles fillore në shkollë të mesme: Sfidë apo Kërcim?” thekson se: Nxënësit kanë përzierje ndjenjash kur vë reja tek tranzicioni prej shkollës fillore në shkollë të mesme, meqenëse nxënësit mezi presin të shkojnë në shkollë të mesme duke pasur rezerva brenda vetës, por nxënësit kanë dëshirë të sfidohen, të kenë më shumë liri, dhe krijim të shoqërisë.

Grupi i autorëve (S., Lester, L., Wenden, E., & Cross, D., 2012) në librin e titulluar “Zbulim teorik i shprehjeve emocionale dhe shoqërore gjatë tranzicionit prej shkolles fillore në shkollë të mesme” theksuan se: Jo vetëm nxënësit por edhe shoqëria ka përfitime nga nxënësit e talentuar të cilët nuk mungojnë në procesin mësimor për shkak që mund të ketë rënie të suksesit. Mungesa në procesin mësimor, rënia e suksesit dhe braktisja e procesit mësimor duhet të shmangen sa më shumë që munden.

Nxënësit të cilët kanë probleme gjatë tranzicionit prej shkollës fillore në shkollë të mesme ndihen jo të respektuar, ndihen inferior ndaj të tjerëve, dhe ky proces mund të shkaktojë mos angazhim, rënie të suksesit, dhe braktisje të procesit mësimor.

Departamenti i Arsimit dhe trajnimeve (Arsimit, 2000) të Melburnit në Australi me titull “Përshtatja gjatë tranzicionit prej shkollës fillore në shkollë të mesme deklaruan se: Tranzicioni prej shkollës fillore në shkollë të mesme është proces reformues dhe në mënyrë që të jetë efikas duhet të kalojë përmes disa fazave. Elementet thelbësore gjatë tranzicionit janë sfiduese dhe brengosëse si për nxënësit ashtu edhe për prindërit, por qëllimi kryesor i tranzicionit prej shkollës fillore në shkollë të mesme përfshin vetëbesimin e nxënësit, kompetencat akademike si dhe parandalimin e sjelljeve të dobëta (liga) si keqpërdorimi, depresioni dhe vetëvrasja. Ndryshimi i shoqërisë, mësimdhënësit e ndryshëm shkaktajnë që disa nxënës të kenë dobësi në këtë fazë të zhvillimit dhe tranzicionit. Prindërit duhet ti ndihojnë nxënësit që të përshtatën në ambientin shkollor, prindërit duhet të konsultohen me fëmijën e tyre rreth pritjeve të tranzicionit prej shkollës fillore në shkollë të mesme. Prindërit sqaruan kultuarat e ndryshme mësimore të shkollës fillore dhe shkollës së mesme siq janë mungesa e njohjes së shkollës së mesme, mësimdhënësit e ndryshëm si dhe nxënësit e rinjë. Me këto ndryshime, prindërit duhet të sigurojnë fëmijën që tranzicioni prej fillore në shkollë të mesme është tejet pozitiv. Në lidhje me tranzicionin prej shkollës fillore në shkollë të mesme, mësimdhënësit shprehën shqetësimet e tyre lidhur me mirëqenien e nxënësve gjatë fazës së tranzicionit, krejt kjo varet nga mënyra e veprimit të shkollave gjatë programit të tranzicionit, si dhe mbështetja e parimeve dhe praktikave të zhvilluara gjatë shkollimit në shkollë të mesme.

Tranzicioni prej shkollës fillore në shkollë të mesme nuk është një proces i lehtë, tranzicioni nuk është vetëm mbarim i procesit mësimor ose vetëm tranzicion në shkollë tjetër, por thekson edhe kohë të konsiderueshme dhe ndryshime në jetën e nxënësve.

Autorët (Sharon Cox, Shelley Kennedy, 2008) në librin e titulluar “Arritjet e nxënësve gjatë fazës së tranzicionit prej shkollës fillore në shkollë të mesme” theksuan se: Gjatë fazës së tranzicionit nxënësit kalojnë lloje të ndryshme fizike, emocionale, ndryshime shoqërore dhe sfida. Për disa nxënës, procesi i tranzicionit nuk ka të bëjë vetëm me përshtatjen në ambientin e ri shkollor, por është edhe përshtatje me mësimdhënësit e rinj, pikëpamjet e reja mësimore, përshtatje me lëndët mësimore, pritjet shkollore, si dhe bashkëpunimin me nxënësit e rinjë. Tranzicioni në shkollë të mesme është tejet sfidues për nxënësit pasi që ata ballafaqohen me

ndryshime dhe kjo ka ndikim madhor në atë se si ndihen ata rreth shkollës, procesit mësimor dhe zhvillimit të tyre në shkollë të mesme.

Gjithashtu lidhur me tranzicionin kanë shkruar edhe autorët (West, P., Sweeting, H. & Young, R. , 2010) në revistën shkencore të titulluar “çështjet e tranzicionit: Përvoja e nxënësve gjatë tranzicionit prej shkollës fillore në shkollë të mesme në veri të Skocisë dhe pasojat e mirëqenies” ku treguan se: Bazuar në kërkimet e tyre, ata gjetën se faktorët kryesor që ndikojnë në rënien e suksesit gjatë fazës së tranzicionit prej shkollës fillore në shkollë të mesme nuk kanë mundur të gjejnë përgjigje konkrete por janë munduar të gjejnë disa të dhëna që mund të ndikojnë në rënien e suksesit si metodologjia e mësimdhënësve, kurrikula prej fazës së tranzicionit prej fillores në shkollë të mesme, ndryshimet e shkollës fillore me shkollën e mesme, faktorët social, përkrahja familjare, përshtatja në shkollë të mesme dhe efikasiteti i nxënësve. Ky konkludim mbështetet edhe nga autorët (Akos, P. & Galassi, J. , 2004) në revistën shkencore të titulluar “Tranzicioni I shkolles se mesme duke u bazuar tek studentët, prindërit dhe mësimdhënësit” theksuan se: Tranzicioni prej shkollës fillore në shkollë të mesme shihet si udhëkryqi kryesor tek nxënësit që kalojnë prej një shkolle në shkollën tjetër, prej një klasës më të vogël në klasë më të madhe, ndryshimeve më të mëdha sa i përket arritjeve akademike janë faktor themelor që nxënësit kanë ndryshime dhe rënie të suksesit duke shkaktuar depresion dhe frikë tek nxënësi. Por duke u bazuar në autorin (A.G., 2010) në revistën shkencore të titulluar “Ndjeshmëria akademike gjatë tranzicionit në shkollë të mesme - roli i marrëdhënieve shoqërore” theksoi se:Ky ndryshim ka edhe vetit pozitive edhe negative tek nxënësit pasi që tranzicioni është një hap kthyes për arritje të mëdha akademike.

Autori (Hines, 2007) në revistën e titulluar shkencore “Përshtatja e nxënësve gjatë tranzicionit në shkollë të mesme: Kryqëzimi I divorcit dhe gjinise.” Tranzicioni prej shkollës fillore në shkollë të mesme shihet si fazë e ndryshimeve njohëse, psikologjike, dhe ndryshimeve emocionale.

Autori (Darmody, 2008) në revistën shkencore të titulluar “Hartimi I barrierave ne tranzicionet e sukseshme te shkolles ne krahasim,perpektiva- Irlandeze dhe estoneze” theksoi se: Kërkesat e larta nga mësimdhënësit në shkollë të mesme nga mund të shkaktojnë mosinteresim nga ana e nxënësit dhe mund të shpie tek largimi nga shkolla e mesme ose tek rënia e suksesit. Ky është problem madhor sepse braktisja e procesit mësimorë shkakton rënie të suksesit dhe largon

mundësitë për një të ardhme të ndritur për nxënësin. Ky konkludim mbështetet edhe nga autori (Ding, 2008) në revistën e quajtur shkencore “Zbulimi i profileve të ndryshme nëpërmjet analizës profilizuese të rritjes së lartë të shkallëzimit” theksoi se:

Njohuritë e fituara nga shkolla fillore duhet të përshtaten me kërkesat e mësimdhënësve për rritje të nivelit akademik në shkollë të mesme, sepse nëse nuk përshtaten ato si të tilla mund të kenë ndikim negativ duke shkaktuar rënie të suksesit në procesin mësimor.

Autorët (Bru.E., Stornes, T., Munthe, E. and Thuen, E., 2010) në revistën shkencore të titulluar “Përceptimet e përkrahjes së mësimdhënësve ndaj nxënësve gjatë fazës së tranzicionit prej shkollës fillore në shkollë të mesme” theksoi se: Mësimdhënësit luajnë rol kyq kur vë fjala tek tranzicioni prej shkollës fillore në shkollë të mesme, pasi që përkrahja nga ana e mësimdhënësve në përkrahje të nxënësve është element thelbësor për mësimnxënie cilësore. Nxënësit që përkrahen nga mësimdhënësit kanë ambicie pozitive në shkollë dhe mirëqenie pozitive, sociale dhe emocionale. Gjithashtu gjatë fazës së tranzicionit rol të madh luan edhe shoqëria e nxënësve, ky konkludim mbështet edhe nga autori (Weller, 2007) në revistën shkencore të titulluar “Të qëndruarit me shokët e tu? Trajektoret miqësore të nxënësve gjatë tranzicionit prej shkolles fillore në shkolle të mesme” theksoi se: Rol të madhë në tranzicionin prej fillores në shkollë të mesme luajnë edhe shoqëria e nxënësve, pasi që kjo tregon se shoqëria ndihmon në përshtatjen në shkollë të mesme.

Autorët (Driessen G., Sleegers, P., & Smit, F. (2008)., 2008) në revistën e titulluar shkencore “Tranzicioni prej shkolles fillore në shkolle të mesme, meritokracia dhe etnia.” theksuan se: Për të pasur një tranzicion të suksesshëm, disa shkolla mbështeten në notat e nxënësve, këtu përfshihet sukcesi i nxënësit. Zgjedhja e shkollës së mesme përcaktohet nga aftësitë njohëse si performanca dhe rezultatet e testit, si dhe aftësitë e faktorëve si motivimi, dhe vlerësimi i mësimdhënësve. Autori (Weller, 2007) në revistën e titulluar shkencore “Të qëndruarit me shoket e tu? Trajektoret miqësore të nxënësve gjatë tranzicionit prej shkolles fillore në shkolle të mesme” theksoi se: Në mënyrë që të kemi tranzicion të suksesshëm tek nxënësit që janë në rrezik për tranzicion të dobët duhet marrur hapa për të siguruar informata të duhura dhe aktivitete përkrahëse siq janë shoqëria, por këtu duhet kuptuar që nxënësi duhet të mendojë për strategjitë e arritjes për të qenë i pavarur në shkollë të mesme pasi që këtë gjë e ofron edhe

kurrikula. Autorët (McTaggart, P., & Sanders, M., 2003) në revistën e titulluar shkencore “Tranzicioni në projektin shkollor: Rezultatet në Klasë theksoi se: Mësimdhënësit të cilët japin kontribut në përkrahje të nxënësve gjatë fazë së tranzicionit nuk kanë mjaft njohuri rreth nxënësve. Duhet patur parasysh mjedisi familjar përfshirë faktorët kulturor dhe socio-ekonomik të cilët tregojnë shumë rreth tranzicionit prej shkollës fillore në shkollë të mesme, ka fëmijë që jetojnë në kushte të vështira dhe si pasojë e kësaj arrijnë rezultate më të vogla dhe kanë rënie të suksesit krahasuar me nxënësit e tjerë në shkollë të mesme.

Departamenti I arsimit dhe zhvillimit të nxënësve në shkollë të mesme (Education, 2014), theksoi se: Tranzicioni I suksesshëm varet nga komunikimi në mes të mësimdhënësve të shkollave fillore dhe shkollave të mesme. Nëse mësimdhënësit bashkëpunojnë me njerëzit të cilët kanë njohuri dhe që I kuptojnë nxënësit, përfshirë edhe familjet e nxënësve, dhe mësimdhënësit lëndor, kjo shpie drejt një tranzicioni të suksesshëm.

Gjithashtu rol kyç në tranzicionin prej shkollës fillore në shkollë të mesme luan rol edhe mjedisi, cilësia e mësimdhënësve, kohëzgjatje e orëve mësimore, si dhe organizimi i kurrikulës si dhe procedurat e përditshme.

Autorja angleze (Evans, 2019) në librin e quajtur “Shqyrtimi i ndikimit të arritjes akademike dhe psikologjike gjatë tranzicionit në arsimin e shkolles së mesme” theksoi se: Treguesi kryesor i tranzicionit prej shkolles fillore në shkollë të mesme është arritja akademike, pasi që arritja akademike është primare për individin dhe mirëqenien e tij, tranzicioni prej shkollës fillore në shkollë të mesme është periudhë kritike e zhvillimit në të cilin shumë nxënës kanë si pikë të dobët arritjen akademike. Rënia e suksesit shoqërohet me pasojat negative si braktisja e procesit mësimor. Shumë aspekte të mjedisit të shkollës së mesme dallojnë nga mjedisi i shkollës fillore dhe kjo mund të ketë ndikim në arritjen akademike përfshirë tranzicionin si mjedisi të ri shkollor, numri më i madh i nxënësve nëpër klasë, kërkesat e ndryshme si ndryshimi i mësimdhënësve, dhe kërkesat e të mësimdhënësve për lëndët e tyre. Grupi I autorëve (Eley, T. C., McAdams, T. A., Rijdsdijk, F. V., Lichtenstein, P., Narusyte, J., Reiss, D., ... Neiderhiser, J. M., 2015) në revistën e titulluar shkencore “Perhapja e frikës: Fëmijet Binjak,” theksuan se: Duhet model teorik për të përshkruar se si mjedisi ndikon në skemën e ndryshimit të nxënësve në aspektin psikologjik dhe akademik, tranzicioni është përkufizim shumë i gjerë

për t'u përshkruar, dhe një ndër faktorët kyq që ndikon në rënien e suksesit është frika.

Tranzicioni ne shkollë të mesme mund të rris frikën tek nxënësi, kërkimet e fundit rreth kësaj çështje kanë sjellur pak ndryshime sa i perket tranzicionit.

Bazuar në autorën angleze (DanielleEvans, 2019) librin e titulluar “Shqyrtimi i rritjes akademike gjatë tranzicionit në shkollë të mesme” në Londër theksoi se: Rëndësia e mirëqenies së nxënësit, respektivisht brenda shkollës thekson që një nga katër nxënësit kanë probleme psikologjike e cila mund të trajtohet. Këtu mund të ndikojnë mësimdhënësit, prindërit gjatë tranzicionit në shkollë të mesme në menyre që nxënësit të ndiejnë praninë dhe mbështetjen e mësimdhënësve dhe prindërve. Shkollat duhet të krijojnë strategji të ndryshme të mbështetjes së nxënësit në rast se nxënësi ndihet inferior ose i ngacmuar.Mbesim me shpresë, se kërkimet e ardhshme shkencore lidhur me mireqënien dhe tranzicionit prej shkollës fillore në shkollë të mesme të gjejnë faktorët kryesor që sigurojnë mirëqenien për nxënësit në përshtatjen në shkollë të mesme.

Bazuar në autorët (McTaggart, P., & Sanders, M., 2003) në revistën e titulluar shkencore “Tranzicioni ne projektin shkollor: Rezultatet ne Klasë” theksuan se: Për të përcaktuar një tranzicion të suksesshëm kjo varet nga dimensionet të cilat duhet të ndiqen,nxënësit krijojnë shoqëri të re dhe përmirësojnë vlerësimin personal, nxënësit duhet të përshtaten në shkollë në menyrë që për prindërit të jetë më e lehtë, dhe normalisht nxënësit duhet të jenë më kureshtar në shkollë të mesme sesa që ishin në shkollën fillore, si dhe të zhvillohet planprogrami i shkollës në mënyrë që të kemi tranzicion të suksesshëm.

KAPITULLI 3

3.1. Analiza e suksesit të marrur nga Drejtoria e Arsimit në Komunën e Lipjanit

Në tabelat në vijim do të paraqesim suksesin e nxënësve gjatë periudhës katërvjeqare për periudhën 2013-2017 të siguruar nga Drejtoria e Arsimit (DKA) në Komunën e Lipjanit, në mënyrë që të paraqesim gjendjen faktike lidhur me faktorët që ndikojnë në rënien e suksesit gjatë tranzicionit prej shkollës fillore në shkollë të mesme- rast studimi Komuna e Lipjanit, Kosovë. Gjithashtu në këto tabela kemi paraqitur rezultatet dhe krahasimet e suksesit të nxënësve gjatë periudhës 2013-2017.

Tabela 1. Raporti i suksesit ne shkollat fillore dhe shkollat e mesme ne komunen e Lipjanit
Viti shkollor 2013/2014

Klasa	9	10
Nr.Paraleleve	45	31
Nr.nxenesve	1004	960

Shkelqyeshem	398	204
Shume mire	190	184
Mire	243	241
Mjafrueshem	166	63
Gjithsej	997	692
Me 1 te pamjaftueshme	0	94
Me 2 te pamjaftueshme	0	104
Me 3 te pamjaftueshme	0	0
Perseritin klasen	7	14
Te panotuar	7	56
NOTA MESGJATARE	2.72	2.93
Mungesa te aryseshme	9280	11187
Mungesa te paarsyeshme	7812	11333
Gjithsej	17082	22520

Bazuar ne tabelen e 1, në komunën e Lipjanit gjatë periudhës 2013-2014 në shkollat fillore në Komunën e Lipjanit pati 76 paralele, në shkollat fillore pati 45 paralele kurse ne shkollat e mesme 31 paralele me gjithsej 1964 nxenes. Ne shkollat fillore pati 1004 nxenes prej tyre 398 nxenes ose (39,68%) me sukses te shkelqyeshem, 190 nxenes ose (18,92%) ishin me sukses te shume mire, 243 nxenes ose (24,2%) ishin me sukses te mire, 166 ose (16,53%) ishin me sukses te mjaftueshem, gjithsej 997 nxenes ose (92 %) të kalueshmërisë në nivel komune, si dhe kishin perseritur klasen 7 nxenes ose (0,69%), po ashtu kemi 7 nxenes te panotuar ose (0,69%). Kurse ne shkollat e mesme ne komunën e Lipjanit gjatë periudhës 2013-2014, bazuar ne grafiken e pare (1) gjatë fazës së tranzicionit prej shkolles fillore në shkolle të mesme kishte numër me te vogel te nxenesve 960 nxenes qe ndjekin mesimin ne shkollat e mesme ne Komunën e Lipjanit, prej tyre me sukses te shkelqyeshem 204 nxenes ose (21,25%), 184 nxenes ose (19,16%) me sukses shumë të mirë, 241 nxenes ose (25,1%) me sukses të mirë, 63 nxenes ose (6,56%) ishin me sukses te mjaftueshem kurse gjatë periudhës 2013-2014 kemi gjithsej 692 nxenes ose (72,08%) të kalueshmërisë, kurse kemi 94 nxenes ose (9,79 %) me nje (1) te pamjaftueshme, 104 me dy (2) te pamjaftueshme ose (11%) kurse kemi 14 nxenes ose (1.5%) qe e perserisin klasen, kurse 56 nxënës ose (5,83%) ngelen te panotuar.

Tabela 2. Raporti i suksesit ne shkollat fillore dhe shkollat e mesme ne komunën e Lipjanit Viti shkollor 2014/2015

Klasa	9	10
Nr.Paraleleve	53	30
Nr.nxenesve	1543	906

Shkelqyeshem	500	153
Shume mire	271	197
Mire	340	242
Mjaftueshem	189	72
Gjithsej	1300	664
Me 1 te pamjaftueshme	5	75
Me 2 te pamjaftueshme	0	43
Me 3 te pamjaftueshme	0	34
Perseritin klasen	0	36
Te panotuar	38	54

Mungesa te aryseshme	15040	14188
Mungesa te paarsyeshme	12904	11384
Gjithsej	27944	25572

Bazuar ne grafiken 42, vërejmë se 86% e mësime dhënëseve theksuan se interesimi me I madh I prindërve ndikon pozitivisht ne sjelljen dhe permirsimin ne mesimnxenie e nxënësve, ndersa 14% e mësime dhënëseve theksuan qe ndikon ne sjelljen dhe vijueshmerine e nxenesve .


Pyetja 11. Sa jeni të kënaqur me përgatitjen e nxënësve nga shkolla fillore ?



Grafika 43. Vleresimi I mesimdhenesve per pergatitjen e nxenesve ne procesin mesimor

Bazuar ne grafiken 43, 54% e mesimdhenesve theksuan se ata jane mire te kenaqur me arritjet nga shkollat fillore, 36% e mesimdhenesve theksuan se ata jane shume te kenaqur ndersa 8% e mesimdhenesve theksuan qe jane pjeserishte te kenaqur si dhe kemi 2% qe jan aspak te kenaqur me arritjet e nxenesve nga shkolla fillore

Pyetja 12. Sipas jush, Cfarë periudhe kohore I nevojitet nxënësit për tu adaptuar në shkollë të mesme ?




Grafika 44. Adaptimi I nxenesve ne shkolle.

Bazuar ne grafiken 44, 71% e mesimdhenesve theksuan se nxenesve per tu pershtatur me ambientin e ri shkollos ne shkolle te mesme I nevojiten dy deri ne tre muaj, ndersa 21% e mesimdhenesve theksuan se nxenesve I nevojiten me pak se nje muaj per tu pershtatur ne

ambientin e ri sic eshte shkolla e mesme, kurse kemi 8% e mesimdhenesve qe theksuan se disa nxenesve mund tju marr deri ne nji vit te pershtaten ne shkolle te mesme.


Pyetja 13. Cilët faktorë ndikojnë që nxënësit të adaptohen më lehtë në shkollë të mesme ?



Grafika 45. Faktoret ndikues te adaptimit ne shkolle te mesme.

Bazuar ne grafiken 45,verejme 50% e mesimdhenesve theksuan se faktoret qe ndikojne qe nxenesit te adaptohen ne shkolle te mesme jane metodat e mesimdhenies dhe materialet udhzuese nga mesimdhenesit,30% e mesimdhenesve theksuan se factor munde te jete edhe pershtatja me shoqerine ,ndersa 15% theksuan qe ndikojne aktivitetet sociale dhe 5% theksuan qe ndikon kurrikula


Pyetja 14. Sa jeni të kënaqur me vijueshmërinë e nxënësve në orën tuaj mësimore?



Grafika 46. Vijueshmeria e nxenesve ne procesin mesimor.

Bazuar ne grafiken 46, 47% e mesimdhenesve te shkollave te mesme theksuan se ata jane shume te kenaqur me vijueshmerine e nxenesve ne procesin mesimor, 45% e mesimdhenesve theksuan se ata jane te kenaqur mesatarisht me vijueshmerin e nxenesve ne lenden e tyre mesimore, 8% e mesimdhenesve theksuan se ata jane pak te kenaqur sa l perket vijueshmerise se nxenesve ne procesin mesimor. Bazuar ne analize, në përgjithësi mund te themi se mesimdhenesit e shkollave te mesme ne komunen e Lipjanit janë shume te kenaqur me vijueshmerine e nxenesve ne procesin mesimor.


Pyetja 15. Në grupin e nxënësve tuaj a keni (ose njihni) nxënës që janë të detyruar të punojnë jashtë procesit mësimor?



Grafika 47 Numri I nxenesve qe punojn jashte procesite mesimore.

Bazuar ne grafikën 47,82% e mesimdhenesve theksuan se ata nuk kanë nxënës që janë të detyruar të punojnë jashtë procesit mësimorë,ndersa (18%) e mesimdhenesve theksuan se ata kane nxenes qe eshte l detyruar te punoj jashte procesit mesimore.


Pyetja 16. Në grupin tuaj të nxënësve tuaj, a keni nxënës nga vise rurale që kanë probleme me vijueshmërinë?



Grafika 48. Nxenesit nga viset rurale

Bazuar ne grafiken 48, 53 % e mesimdhenesve theksuan se ata kanë nxënës/e qe vijne nga viset rurale dhe kane probleme me vijueshmerine ne procesin mesimor, kundrejt 46% e mesimdhenesve qe theksuan se nuk kane nxenes qe vijne nga zonat rurale.


Pyetja 17. Sa i përkrahni nxënësit për lehtësimin e mësimnxënies jashtë orarit të rregullt ?



Grafika 49. Përkrahja e mesimdhënësve për nxënësit jashta procesit mesimor

Bazuar në grafiken 49, 90% e mesimdhënësve theksuan se i përkrahin nxënësit mesatarisht sa i përket mësimnxënies jashta procesit mesimor, 8% e mesimdhënësve theksuan se i përkrahin pak, kurse 2% theksoi aspak i përkrahin nxënësit në mësimnxënie jashta procesit mesimor.

Pyetja 18. Sa jeni të kënaqur me raportin mësimdhënës-nxënës sa i përket procesit mësimorë?



Grafika 50. Raporti mesimdhënës-nxënës

Bazuar në grafiken 50, 92% e mesimdhënësve theksuan se janë shumë të kënaqur me raportin mësimdhënës-nxënës lidhur me procesin mësimor, kurse (8%) e mesimdhënësve janë pak të kënaqur me raportin mësimdhënës.

3.5. Diskutimet dhe Rezultatet me nxënësit

Në këtë pyetësor kontribuan 50 nxënës të shkollave të mesme profesionale dhe 50 nxënës të shkollave të mesme të gjimnazits. Shumica e nxënësve që u përgjegjën në pyetësor janë nxënës të vitit të parë (shkolla e mesme) dhe kanë mbaruar shkollën fillore në zona rurale.

Nga analiza e rezultateve kemi keto perfundime:

Përzgjedhja e shkollës/profesionit të përshtatshëm është ndër faktorët kryesor që ndikon në suksesin e treguar si në shkollimin e mesëm poashtu edhe në atë të lartë si dhe në karrierë. Gjetjet për sygjerimet e marra për përzgjedhjen e shkollës, dalin se pothuajse gjysma e nxënësëve kanë sygjerime nga prindërit, shumica e mbetur vendosin vet dhe një pjesë shumë e vogël ndikohen nga faktor tjerë. Mirëpo për këtë qështje shumë të ndieshme e të rëndësishme ka nevojë për mbështetje më të madhe profesionale nga njerëzit që bëjnë politikën arsimore dhe udhëheqin me arsimin në përgjithësi në të gjitha nivelet.

Sa i përket njohurive apo përgaditjes shkollore nga niveli fillor vetëm 21%, e nxënësve theksuan se janë shumë të knaqur me njohuritë e fituara në shkollën fillore. Dhe 37% e tyre kishin treguar rezultat të shkëlqyeshëm. Kjo tregon që jo të gjithë nxënësit e shkëlqyeshëm janë të knaqur me njohuritë që i kanë marrë dhe patjetër që është edhe një tregues i rëndësishëm i pasigurisë së tyre rreth përshtatjes në një nivel më të lartë shkollimi i cili nënkupton që është arritur niveli i caktuar i njohurive dhe kompetencave, ndërkohë që mungesa e tyre krijon boshllëqe, që për një numër të caktuar të nxënësëve rezultojnë detyrimisht në rënje të suksesit. Kjo vërtetohet sidomos nga statistikat e komunës sipas të cilave kryesisht gjatë viteve ka rënie në suksesin e nxënësëve të shkëlqyeshëm. Sipas këtyre statistikave në periudhën 2013-2017 prej 36,51% nxënës të shkëlqyeshëm kemi rënie në 14,87%, nga 20,07% nxënës me sukses shumë mirë në 18,37, nga 26,43% nxënës me sukses të mirë në 30,00% nga 16,34% me sukses të mjaftueshëm në 14,17 % dhe nga 0% përsëritës në 2,71%(Tabela.4).

Suksesi në lëndët bazike gjuhë shqipe, gjuhë angleze dhe matematikë është faktor shumë i rëndësishëm për orientim të nxënësëve në gjimnaze apo shkollë profesionale dhe sipas rezultateve të gjetura në lëndën e gjuhës shqipe rezultatet janë shumë më të mira dhe pastaj

ato bien në gjuhën angleze e poashtu edhe në matematikë. Megjithatë jo në atë shkallë sa të mund të jetë njëri prej indikatorëve të suksesit të mëtejshëm, të paktën jo nga rezultatet e gjetura.

Bashkëpunimi mesimdhënës-nxënës është një aspekt i rëndësishëm që ndikon direkt në procesin e mesimdhënies dhe mesimnxënies. Në pyetjen drejtuar nxënësëve për bashkëpunimin në fjalë vetëm 34% e tyre u përgjigjën se është plotësisht i kënaqshëm, 32% i kënaqshëm. Por kur krahasojmë përgjigjet e marra për të njëjtën pyetje nga mesimdhënësit kemi një mospërputhje të madhe (92% e tyre shprehën që bashkëpunimi është shumë i kënaqshëm) dhe normalisht duhet të punohet shumë në këtë drejtim për të përmirësuar bashkëpunimin apo për ta kuptuar drejt se çka në të vërtetë mund të quajmë bashkëpunim të kënaqshëm apo të suksesshëm.

Ambienti shkollor i cili i'u ofrohet nxënësëve, sipas përgjigjeve të marra i plotëson pritshmëritë dhe është mjaftueshëm i kënaqshëm, mirëpo të njëjtit nxënës shprehën se shkolla ofron kushte të mira apo mesatarisht të mira. Kjo gjithashtu bën një kundërthënie në vete sepse numri i nxënësëve prej 42% të kënaqur me ambjentin shkollor, zvoglohet në 10% të atyre që mendojnë që shkolla ka kushte shumë të mira për mësim.

Sa do të ndikojë shkollimi i mesëm në sukses të mëtejshëm dhe në karrierë (Pyetje 19), kthen një rezultat interesant. Shumica prej tyre përgjigjen se do të ndikojë pak ose mesatarisht pak. Krejt kjo si pasojë e gjendjes sociale dhe kushteve që nxënësit tanë jetojnë e mësojnë aktualisht. Shembuj suksesi ku të rinjtë vetëm duke mësuar kanë siguruar një perspektivë të ndritur apo i'a kanë dalë të zgjedhin profesionin i cili i'u siguron një jetë dinjitoze, janë shumë të pakt. Ky është një ndër faktorët që demotivon nxënësit në shkallë të madhe. P.sh shkollat e mesme profesionale do të duhej të kishin për qëllim që të i'u sigurojnë nxënësëve praktikë të vazhdueshme dhe punësim të shpejtë, mirëpo realiteti ende është shumë larg në mbarë vendin tonë.

Faktorët jashtëshkollor që ndikojnë në suksesin e nxënësëve (Pyetje 30) kthen rezultate të njohura për ne. Më pak se gjysma e tyre (41%), përgjigjen që tashmë kanë filluar punë kjo si pasojë e kushteve të rënda që një pjesë e madhe e shoqërisë sonë jeton. Nxënësit që ndjekin procesin procesin mësimor dhe paralelisht punojnë kanë probleme të shumta si lodhja,

moskoncentrimi apo kanë numër të madh të mungesave për arsyt e shënuara më lartë. Gjendja financiare(20% e nxënësëve), është një ndër faktorët që ndikon në procesin mësimor dhe direkt në gjendjen emocionale të nxënësëve. Nxënësit me probleme financiare nuk vijnë mirë të përgaditur me mjete shkollore gjithashtu ndjehen keq për shkak të dallimit që kanë me moshatarët e tyre apo në rastet më ekstreme bëhen pre e bullizmit dukuri kjo që i'u shkakton dëme të pariparueshme në personalitetin e tyre.

3.5.1. Diskutimet dhe Rezultatet me mësimdhënësit

Ne pyetsorine me mesimdhënes morren pjese gjithsej 50 mesimdhënes, 34 (68% mesimdhënes) dhe 16(32%) mesimdhënes. 53% prej tyre punojne ne shkollen e mesme te gjimnazit dhe 47% punojnë ne shkollen e mesme profesionale .

Sipas rezultateve te analizuara ne pyetesorin me mesimdhënes kemi keto perfundime: Ne lidhje me bashkpunimin e prinderve me mesimdhënes (Pyetja 8) per nje tranzicion te suksesshem, eshte nje bashkepunim mesatar ku 48% e mesimdhënesve deklaruan se kane bashkpunim mesatar dhe 36% shume pak bashkpunim 4% gjithmon bashkpunim dhe 12 % aspak bashkpunim. Sipas rezultateve të gjetura për pyetjen në fjalë del që mungon bashkpunimi i duhur mes prindërve dhe mësimdhënëësëve për pasoje edhe na del që është njëri prej faktorëve për t'u konsideruar në rënien e suksesit gjatë kalimit të nxënësëve nga niveli më i ulët i shkollimit në nivel më të lartë. Fakt ky i mbështetur edhe nga mendimet e e 86% të mësimdhënëësëve të cilët u përgjegjën në pyetjen se a ndikon pozitivisht bashkpunimi i prindërve dhe mësimdhënëësëve në suksesin e nxënësëve.

Në përgjithësi, mësimdhënësit mbajnë kontakte më të shpeshta me prindërit e nxënësve “problematicë”. Në këtë mënyrë anashkalohen shumë fenomene të tjera që shoqërojnë zhvillimin e fëmijëve si personalitete unike dhe që kërkojnë një vëmendje të qëllimshme si nga prindërit, ashtu dhe nga mësuesit. Vështirësitë e socializimit në grup, sidomos gjatë kalimit nga niveli fillor në atë të mesëm, numri i madh i nxënësve në klasa krijon probleme dhe vështirësi

në përshtatjen e fëmijëve dhe adoleshentëve me njëri-tjetrin, që reflektohet më pas te marrëdhënia me mësuesit dhe prindërit gjithashtu në rënjen e suksesit.

Sipas rezultateve të gjetura për bashkëpunimin mes mesimdhënësëve dhe nxënësëve del se ky bashkëpunim është shumë i kënaqshëm, ku 92% e mesimdhënësëve deklaruan se janë shumë të kënaqur ndërsa 8% janë pak të kënaqur. Mirëpo kur merret parasysh gjendja faktike sipas rezultateve nga statistikat zyrtare të komunës (poashtu mospërputhja me përgjegjet e nxënësëve), ky rezultat është mjaft i diskutueshëm dhe duhet gjetur mënyra që ky bashkëpunim i kënaqshëm të mund të rezultojë edhe në suksese të kënaqshme të nxënësëve gjatë këtij tranzicioni dhe jo vetëm.

Një çështje tjetër shumë e rëndësishme që ja vlen të konsiderohet është edhe edhe përgaditja shkollore e prindërve të nxënësëve (Pyetja 41). Sipas statistikave që mesimdhënësit ruajn për përgaditjen shkollore të nxënësëve të tyre, në bazë të përgjegjëve të marra, rezulton se gati gjysma e tyre kanë vetëm shkollën fillore (42%), 38% shkollën e mesme pjesa tjetër që mbetet me fakultet apo master. Prindërit janë mbështetësit kryesor për fëmijët e tyre në çdo aspekt, janë njëri ndër komponentet kyçe të trekëndëshit pedagogjik. Prindërit me edukim fillor apo të mesëm me gjithë dëshirën e madhe që mund të kenë për të ndihmuar fëmijët e tyre në nxënjen e njohurive të reja, e kanë të pamundur sepse njohuritë e tyre janë shumë të kufizuara dhe maksimumi mund të motivojnë fëmijët dhe t'i mbështesin matrejalisht.

Ndryshimi i ambientit shkollor, përfshirë këtu edhe shoqërinë (nxënësit shkojnë në shkollë të ndryshme, klasa të ndryshme, kanë rreth shoqëror tjetër), kërkon një periudhë kohore për përshtatje. Sipas rezultateve të marra (Pyetja 12), duhen dy deri tre muaj për ambientim, periudhë kjo shumë e konsiderueshme gjatë së cilës secili prej nxënësëve vlerësohen për periodën e parë, nota këto që ndikojnë edhe në rezultatin përfundimtar (tashmë sipas kurikulës së re vlerësimi është sistematik dhe nota përfundimtare nuk mund të përmirësohet në fund të vitit).

Përkrahja e nxënësëve për lehtësimin e mësimnxënies (Pyetja 17), sidomos gjatë periudhës së përshtatjes me ambientin e ri mësimor është shumë e nevojshme. Mesimdhënësit shprehën se i'u ndihmojnë atyre shumë apo mesatarisht. Por, në realitet nëse kjo përkrahje është reale ka

shumë hapsira për ndryshim në këtë qasje. Mënyra e komunikimit dhe përkrahja apo raporti mësues-mësues (Pyetja 18) na rezulton i kënaqshëm apo mesatarisht i kënaqshëm, mirëpo nëse nuk përkthehet në rezultate konkrete duhet ndryshuar me patjetër. Është thelbësore që mësuesit të fitojnë besimin e nxënësve në fillim të vitit.

KAPITULLI 4

4.1. Përfundimi

Nxënësit kanë nevojë që përshtatja në shkolla dhe klasa të reja të kalojë sa më mirë që është e mundur në mënyrë që mirëqenia e tyre mos të rrezikohet dhe nxënja të qëndrojë koherente e vazhdueshme, pasi që ky tranzicion shoqërohet me shumë stres dhe ndikon direkt në suksesin e tyre të mëtejshëm.

Ne kete punim e kemi analizuar situaten e renies se suksesit nga shkolla fillore ne shkolle te mesme ne shkollat e komunes se Lipjanit.

Rezultatet zyrtare të statistikave të suksesit të nxënësëve për periudhën 2013-2017, marrë nga Drejtoria Komunale e Arsimit të komunës së Lipjanit(nota mesatare në fund të klasës së nëntë dhe të dhjetë), janë me sa vijon:

Gjenerata 2013-2014, në fund të klasës së nëntë ka mesataren 3,72, kurse po e njejta gjeneratë në fund të vitit shkollor 2014-2015 ka mesataren 3.3, pra ka rënie për 0,42.

Gjenerata 2014-2015, në fund të klasës së nëntë ka mesataren 3,56, kurse në fund të klasës së dhjetë, viti shkollor 2015-2016, ka mesataren 3,28. Prap kemi rënie për 0,28.

Gjenerata 2015-2016, në përfundim të klasës së nëntë ka mesataren 3.6 dhe po e njejta gjeneratë në fund të vitit vijues (2016-2017) del me mesataren 3.16, me rënie të suksesit për 0,44. Gjithashtu një dukuri e vrejtur në këto statistika është që edhe numri i mungesave është shumë më i madh në klasat e X-ta se në klasat e IX-ta.

Për rënien e suksesit në këtë periudhë tranzicioni si dukuri e përgjithshme, fillimisht shtruum tre hipoteza te cilave donim t'u jepnim pergjigje respektivisht te konstatojme qe ato hipoteza janë te vlefshme edhe per nxenesit e shkollave të komunes se Lipjanit e njëkohësisht të identifikohen faktorët e mundshëm që kanë ndikim në këtë rënie. Vertetimin e ketyre hipotezave e kemi bere duke analizuar te dhënat e marrura nga drejtoria e arsimit ne komunën e Lipjanit, si dhe pergjigjet e nxenesve dhe mesimdhenesve. Vlene te theksohet se analiza e

berë në këtë punim ka qenë gjithëpërfshirëse, duke vlerësuar të gjitha faktorët që ndikojnë në rritjen e suksesit gjatë kalimit nga shkolla fillore në ato të mesme.

Komponentet kryesore të trekëndëshit pedagogjik janë kyç kur është fjala për një tranzicion të suksesshëm dhe për rezultate të mira në përgjithësi. Gjetjet nga rezultatet tregojnë se ka ngjeshje në komponentet e këtij trekëndëshi. **Bashkpunimi i prindërve me mësimdhënësin është mesatar por jo i mjaftueshëm (48% e mësimdhënëseve deklarojnë bashkpunim mesatar).** Kurse bashkpunimi mësimdhënësi-nxënësi sipas mësimdhënëseve është shumë i kënaqshëm (92%), ndërkohë që nxënësit mendojnë ndryshe, vetëm 34% e tyre mendojnë që është plotësisht i kënaqshëm.

Ndaj dhe hipoteza e parë është vërtetuar nga mospërputhja e përgjigjeve si dhe nga statistikat që tregojnë rritje në sukses.

Kalimi i nxënëseve nga niveli fillor në nivelin e mesëm mund të jetë i komplikuar dhe shoqërohet me ndryshime sociale, emocionale dhe fizike, të cilat mund të ndikojnë negativisht në të nxënësit e tyre. Gjendja sociale ka bërë që një numër shumë i madh i nxënëseve (41%) punojnë dhe vijojnë shkollimin paralelisht. Një pjesë e tyre (20%) gjenden financiare e shohin si pengesë të madhe shtu këtu edhe gjendjen emocionale që rëndohet. Gjithashtu edhe përgaditja shkollore e prindërve është shumë e ulët, vetëm 20% e tyre kanë shkollim të lartë. Mirëpo se suksesi në fund të çdo viti shkollos është faktor për tranzicion të suksesshëm nuk mund të konfirmohet pasi që pikrisht rritja më e madhe në sukses sipas statistikave, vërehet te nxënësit e shkëlqyeshëm, përqindja e të cilëve bie në mënyrë drastike (Gjatë periudhës 2013-2017, prej 36,51% bie në 14,87%, tabela 4). Kështu që mund të themi që hipoteza e dytë në bazë të gjetjeve nuk mund të vërtetohet plotësisht.

Zakonisht shkollat fillore kanë numër më të vogël të nxënëseve (sidomos zonat rurale), krahasuar me shkollat e mesme të komunës sonë. Ndaj edhe nxënësit gjatë këtij tranzicioni gjejnë një ambient dhe mjedis shoqëror të ri. Ndryshimi i ambientit dhe rrethit shoqëror kërkon gjithashtu një periudhë kohore për përshtatje. Sipas mendimit të mësimdhënëseve (71%), nxënëseve i'u duhen dy deri tre muaj kohë për përshtatje. Ndërkohë që dihet që tre muajt e parë janë përcaktues për vlerësim në periodën e parë (1/3 e vlerësimit të përgjithshëm) e që

ndikon edhe në rezultatin përfundimtar. Gjithashtu këto gjetje janë tregues shumë i qartë që edhe hipoteza e tretë vërtetohet.

Në bazë të rezultateve që fituam konstatojmë se dy hipotezat e parashtruara (hipoteza e parë dhe e tretë) plotësojnë parashikimet tona, kurse hipoteza e dytë nuk vërtetohet plotësisht.

Nevoja për mbështetje dhe përkrahje të nxënësëve në tranzicion dhe përzgjedhje të drejtë është jetike si në performancë në shkollë të mesme, poashtu edhe në edukim të mëtejshëm dhe karrierë. Një ndër hapat e mundshëm mbështetës është vlerësimi i rolit të tre komponentëve të trekëndëshit mësues-nxënës-prindër. Drejtoritë dhe stafet pedagogjike nevojitet të hartojnë plane pune vjetore, me objektiva dhe qëllime të qarta dhe të përshtatura për kushtet dhe specifikat e shkollës.

Shkolla, mësuesi dhe prindërit luajnë rol kyç në zhvillimin e përgjithshëm të nxënësëve.

Prindërit luajnë rol të rëndësishëm në inkurajimin dhe motivimin e fëmijëve. Mbështetja e mirë e tyre ndihmon fëmijët të jenë nxënës pozitiv dhe të suksesshëm gjatë gjithë jetës. Gjithashtu fokusi i mësuesëve është në zhvillimin shoqëror, emocional dhe njohës të nxënësëve të tyre, të vëzhgojë me kujdes, të dëgjojë dhe zbulojë interesin e tyre dhe pastaj t'u sigurojë mundësi për të eksploruar më tej këto interesa. Ndaj është e domosdoshme që secili të kryejë drejt detyrën e vet për nxënës të suksesshëm dhe konkurrenca të denjë me moshatarët e tyre kudo në botë.

REFERENCAT

- A.G. (2010). Ndjeshmeria akademike gjate tranzicionit ne shkolle te mesme. Roli i marredhenieve shoqerore. *Sociology of Education*, (83), 1, 1-19., 1-19.
- Akos, P. & Galassi, J. . (2004). Tranzicioni I shkolles se mesme shikuar nga studentet, prinderit dhe mesimdhenesit. *American School Counsellors Association*, 7(4), 212–220., 212-220.
- Arsimit, D. i. (2000). *School Transition and Resilience Training*. Retrieved from <https://education.vic.gov.au/documents/school/teachers/health/start.pdf>
- Benner, A. D. (2009). Tranzicioni ne shkolle te mesme si process zhvillimi per rinin multietnike te qytetit. *Child Development* 80(2), 356-476.
- Bru.E., Stornes, T., Munthe , E. and Thuen, E. (2010). Students' perceptions of teacher support across the transition from primary to secondary school. *Scandinavian Journal of Educational Research*, 54, 6, 519-533.
- Cueto, S., Guerrero, G., Sugimaru, C., & Zevallos, A. M. (2010). Ndjeshmeria e qasjes dhe tranzicioni ne shkolle te mesme ne Peru. *International Journal of Educational Development*, 30, 277–287., 277-287.
- DanielleEvans. (2019). *Shqyrtimi i rritjes akademike gjate tranzicionit ne shkolle te mesme*. Londer: University of Sussex.
- Darmody, M. (2008). Hartimi I barrierave ne tranzicionet e sukseshme te shkolles ne krahasim,perpektiva- Irlandeze dhe estoneze. *A Journal of the Humanities and Social Sciences*. 12 (62/57), 1, 51-72.
- Ding, C. (2008). Zbulimi I profileve te ndryshme nepermjet analizes profilizuese te rritjes se larte te shkallezimit. *Ndryshimet e trajektores akademike gjate tranzicionit te nxenesve ne shkolle te mesme dhe performanca*, 305-3019.
- Dinham, S. & Roëe, K. . (2008, Fantazia, moda dhefakti: Shkolla e mesme dhe arritjet e nxenesit.). *Fantazia, moda dhefakti: Shkolla e mesme dhe arritjet e nxenesit*. . Retrieved from Researcher.acer.edu: http://research.acer.edu.au/til_misc/6

- Dr. Kate Tillczek & Dr. Bruce Ferguson. (2007). In *Tranzicioni dhe shtigjet nga shkolla fillore ne shkolle te mesme*. Kanada, Toronto: Ministria e Edukimit.
- Driessen G., Slegers, P., & Smit, F. (2008). (2008). Tranzicioni prej shkolles fillore ne shkolle te mesme, meritokracia dhe etnia. . *European Sociological Review*, 26(4), 527–542.
- Education. (2014). Department of Education and Development in High Education. Melbourne: Student Inclusion and Engagement Division.
- Edu-sofia.blogspot.com. (2013). *Thenie per edukaten dhe arsimin*.
- Eley, T. C., McAdams, T. A., Rijdsdijk, F. V., Lichtenstein, P., Narusyte, J., Reiss, D., ... Neiderhiser, J. M. (2015). Retrieved from Perhapja e frikes: Femijet Binjak, 172(7), 630–637.: <https://doi.org/10.1176/appi.ajp.2015.14070818>
- Evans, D. (2019). *Shqyrtimi i ndikimit te arritjes akademike dhe psikologjike gjate tranzicionit ne arsimin e shkolles se mesme*. Londer: University of Sussex.
- Hines, M. (2007). Pershtatja e nxenesve gjate tranzicionit ne shkolle te mesme: Kryqezimi i divorcit dhe gjinise. *Research in Middle Level Education Online*, 31, 2, 1-15., 1-15.
- McTaggart, P., & Sanders, M. (2003). Tranzicioni ne projektin shkollor: Rezultatet ne Klase. . *Australian E-Journal for the Advancement of Mental Health* 2(3), 1-12., 1-12.
- Raphael, B. Raphael B., Schmolke M., Eöoding S., Herrman H., Saxena S., Moodie R. (2005). *Promvoimi i mireqenies dhe shendetit mendor te nxenesve*. Melbourne: Universiteti i Melburnit.
- Rens, M. V. (2017). Tranzicioni prej shkolles fillore ne shkolle te mesme. Si funksionon? Shqyrtim i literatures. .
- S., Lester, L., Eenden, E., & Cross, D. (2012). Zbulim teorik i shprehjeve emocionale dhe shoqerore gjate gjatë tranzicionit prej shkolles fillore në shkollë të mesme. 190-205.
- Sharon Cox, Shelley Kennedy. (2008). In *Arritjet e nxenesve gjate fazes se tranzicionit prej shkolles fillore ne shkolle te mesme*. Në Zealand: The Esplanade Print 81 LTD.

- Sirsch.U. (2003). Tranzicioni prej shkolles fillore ne shkolle te mesme: Sfide apo Kercnim? *International Journal of Behavioral Development*, 27(5),fq.385-395., 385-395.
- Tranzicioni ne shkolle te mesme si process zhvillimi per rinin multietnike te qytetit.80(2),fq.356-476. (2009). 80(2),fq.356-476, 356-476.
- Ëeller, S. (2007). Te qendruarit me shoket e tu? Trajektoret miqesore te nxenesve gjate tranzicionit prej shkolles fillore ne shkolle te mesme. *Children & Society*, 21, 339-351., 339-351.
- Ëest, P., Sëeeting, H. & Young, R. . (2010). Qeshtjet e tranzicionit: Pervoja e nxenesve gjate tranzicionit prej shkolles fillore ne shkolle te mesme ne veri te Skocise dhe pasojat e mireqenies. *Research Papers in Education*, 25(1), 21–50., 21-50.
- Zeedijk, M. S., Gallacher, J., Henderson, M., Hope, G., Husband, B.,& Lindsay, K. (2003). Pereptimet e nxenesve, prinderve dhe mesimdhenesve. *School Psychology International*, 24(1), 67–79., 79.

Shtojca 1: Pyetesor

PYETESORI PER MESIMDHENES/E	
Të nderuar mësimdhënës/e, ky pyetësor është pjesë e hulumtimit shkencor dhe ka për qëllim për të vërtetuar Faktorët që ndikojnë në rënien e suksesit në kalimin nga shkolla fillore në shkollë të mesme . Ky pyetësor ka për qëllim që ju të jepni përgjigjet tuaja në bazë të eksperiencës suaj si mësimdhënës/e. Ju lutem që t'ju përgjigjeni të gjitha pyetjeve me ndere dhe me saktësi. Të dhënat personale do të mbeten anonim.	
1. Gjinia	
Mashkull	Femër

2. Mosha juaj			
Në mes 20 dhe 30 vjet	Në mes 30 dhe 40 vjet	Në mes 40 dhe 50 vjet	
Para pensionit			
3 Ne cilën shkolle ushtroni profesionin tuaj ?			
Gjimnaz	Profesionale	Speciale	
4. Sa keni përvojë pune si mësimdhënës në shkollë të mesme			
Më pak se dy vjet	në mes 2 dhe 5 vjet	Në mes 5 dhe 10	Më tepër se 10 vjet
5. Jeni i angazhuar në grupin e lëndëve			
1. Gjuhët (Gjuhë amtare, gjuha e huaj) 2. Matematikë, Informatikë, Shkencat teknike 3. Shkencat natyrore (Fizik, Kimi, Biologji) 4. Shkencat sociale dhe ekonomike (Histori, Gjeografi, Ekonomi, etj.) 5. Lëndët për shprehje dhe kulturë (Art Muzikor, Art figurativ, Edukatë fizike, etj.)			
6. Sipas Ju nxënësit ndjekin shkollën e mesme për arsye të			
1. Sepse nuk kanë aktivitet tjetër 2. Sepse janë të detyruar nga ndonjë faktor 3. Për tu përgatitur për karrierë 4. Për tu përgatitur për tregun e punës 5. Për tu ngritur dhe edukuar për jetë			
7. Si e vlerësoni bashkëpunimin tuaj, si mësimdhënës në shkollë të mesme, me arsimtarët nga shkolla fillore			
1. Nuk kam bashkëpunim, 2. Shumë rrallë, 3. Mesatarisht 4. Të mirë 5. Permanent			
8. Sa jeni të kënaqur me bashkëpunimin tuaj me prindërit e nxënësve ?			
1. Aspak	2. Shumë pak	3. Mesatarisht	4. Shumë

9. Sa prej prindërve të nxënësve tuaj janë te shkolluar (fakultet e më lartë)?
1-3 4-8 9-12 më shumë se 12
10. Interesimi më i mirë i prindërve, sipas përvojës tuaj
1.Ndikon negativisht te nxënësi 2.Nuk ndikon aspak te nxënësi 3.Ndikon në sjelljen e nxënësit 4.Ndikon në sjelljen dhe përmirësimin e mësim nxënurit
11. Sa jeni të kënaqur me përgatitjen e nxënësve nga shkolla fillore (vlerësoni nga zero deri 5)
0 1 2 3 4 5
12. Sipas Ju, çfarë periudhe kohore i nevojitet nxënësit për tu adaptuar në shkollë të mesme?
13. Cilët faktorë ndikojnë që nxënësit të adaptohen më lehtë në shkollë të mesme? (Rrumbullako)
1. Aktivitete sociale 2. Kurrikullat 3. Materialet udhëzuese nga profesorët 4. Metoda e mësimdhënies 5. Përshtatje me shoqërinë
14. Sa jeni të kënaqur me vijueshmërinë e nxënësve në orën tuaj?
1. Aspak 2.Pak 3.Mesatarisht 4.Shume
15. Në grupin e nxënësve tuaj a keni (ose njihni) nxënës që janë të detyruar të punojnë jashtë procesit mësimor?
Po Jo
16. Në grupin e nxënësve tuaj a keni nxënës nga vise rurale që kanë probleme me vijueshmërinë?

Po	Jo
17. Sa i përkrahni nxënësit për lehtësimin e mësimnxënies jashtë orarit të rregullt	
1. Aspak 2.Pak 3.Mesatarisht 4.Shume	
18. Sa jeni te kënaqur me raportin mësimdhënës nxënës sa i përket procesit mësimor	
1. Aspak 2. Pak 3.Mesatarisht 4.Shume	
Ju faleminderit për kohën dhe konsideratën tuaj.!	

Shtojca 2: Pyetesor

PYETESORI PER NXENESIT			
Te nderuar nxënës/e, ky pyetësorështë pjese e hulumtimit shkencor dhe ka për qellim për te vërtetuarFaktorët qe ndikojnë ne rënien e suksesit ne kalimin nga shkolla fillore ne shkolle te mesme-rast studimi Komuna e Lipjanit. Te dhënat do te mbeten anonim, dhe do te përdorenvetëm për hulumtim.			
1.Gjinia (Rretho germën)			
M		F	
2.Ne cilën shkolle jeni ? (Rrethofjalën/fjalinë)			
Gjimnaz	Shkolle Profesionale	Shkollë e veçantë	Tjetër
3. Në shkollë të mesme, për momentin ndiqni vitin e (Rretho numrin)			
1	2	3	4
4. Ku keni mbaruar shkollën fillore? (Rrethofjalën/fjalinë)			
Qytet		Fshat	
5. Për të arritur në shkollë fillore keni udhëtuar (Rrethofjalën/fjalinë)			
Më pak se 0.5 km	Nga 0.5 km deri 1km	Nga 1km deri 2km	Me shume se 2 km
6.Sa jeni te kënaqur me njohuritë qe keni marre nga shkolla fillore?(Rrethofjalën/fjalinë)			
Aspak i kënaqur	Pjesërisht i kënaqur	I kënaqur	Shume i kënaqur
7. Sukses i juaj nga shkolla fillore është (mesatar për 4 vitet e fundit)(Rretho numrin)			
2	3	4	5
8. Sukses i juaj në gjuhë amtare nga shkollë fillore është(Rretho numrin)			
2	3	4	5
9. Sukses i juaj në gjuhë huaj nga shkollë fillore është(Rretho numrin)			
2	3	4	5

10. Suksesi juaj në matematika nga shkollë fillore është (Rretho numrin)				
2	3	4	5	
11. Gjatë shkollës fillore mesatarisht për vit shkollimi,mësimin e keni ndjekë (Rrethofjalën/fjalinë)				
Më pak se 50%	në mes 50% dhe 70%	në mes 70% dhe 90%	mbi 90%	
(këta përqindje mund t'i rregulloni më mirë, ose shpreheni me dite mungese në mësim – mesatarisht brenda një viti, p.sh.				
Më pak se 10 ditë	mes 10 dhe 20 ditë	mes 20 dhe 30	me tepër se 30	
12.Ne zgjedhjen e kësaj shkolle,sugjerime keni marrë nga ? (Rrethofjalën/fjalinë)				
Vetë vendosa	Prindërit	Shoqëria	Arsimtarët	Zgjedhje e rastësishme
13. Cilat janëpritshmëritë nga shkolla e mesme ? (Rrethofjalën/fjalinë)				
1. Përgatitëmpër karrierë, 2. Fitoj njohuri të reja, 3. Njoftoj shoqëri të re , 4. Përgatitëmpër tregun e punës 5. Nuk pres asgjë ose nuk e di				
14. Cili është motivi qe keni regjistruar/vini në shkollë të mesme? (Rrethofjalën/fjalinë)				
Jam i detyruar Dëshira e prindërit Te përgatitëmpër karriere te mëtutjeshme Te behëm i suksesshëm Arrij rezultate personale				
15. Shkolla të cilin ndiqni, nga shtëpia juaj (vendbanimi ku jetoni) është larg (Rrethofjalën/fjalinë)				
1. më pak se 1 km 2. 1 km deri 3 km 3. 3 km deri 5 km 4. 5 km deri 10 km 5. më larg se 10 km				

16. Sa kohë harxhoni deri të arrini në shkollë (Rrethofjalën/fjalinë)				
1. më pak se 0.5 orë 2. . 0.5 deri 1 orë 3. 1 orë deri 2 orë 4. . më shumë se 2 orë				
17. Sa jeni të kënaqur me ambienti shkollor? (Rrethofjalën/fjalinë)				
I pakënaqur	I kënaqur	Mesatarisht	I kënaqur	Shume i kënaqur
18. Sa i plotëson kushtet për mësimnxënie shkolla juaj? (Rrethofjalën/fjalinë)				
Aspak	Shumë pak	Mesatarisht	Mirë	Shumë mirë
19. Sa do te ndikoj shkolla e mesme ne suksesin, karrierën tuaj ? (Rrethofjalën/fjalinë)				
1 Nuk do te ndikoj aspak 2. Do të ndikoj pak 3. Do të ndikoj mesatarisht 4. Do të ndikoj konsiderueshëm 5. Do të ndikoj shumë				
20.Çfarë suksesi keni arritë ose mendoni te arrini (nëse jeni viti i parë) në shkollë të mesme? (Rretho numrin)				
2	3	4	5	
21.Sipas ju, sa ndiqni/vijoni procesin mësimor? (Rrethofjalën/fjalinë)				
më pak se 50%	51-74%	75-94%	95-100 %	
22. Sa orë (brenda ditës)i kushtoni mësimi? (p.sh. Lexim, detyra të shtëpisë, ose mësim nxënie) ?(Rretho numrin)				
0	1	2	3	4
23. Krahasuar me orët e mësimi/përgatitjes që keni bërë në shkollë fillore, për përgatitjen në shkollë të mesme, sa orë shtesë (krahasuar me atë në shkollë fillore) në ditë ju nevojiten? (Rretho numrin)				
0	1	2	3	4

24. Vlerësoni kontributin tuaj – pjesëmarrjen tuaj në aktivitetet brenda klasë(Rretho numrin)					
0	1	2	3	4	5
25. Sa jeni te kënaqur me shpjegimin e mësimdhënësve në shkollë të mesme (vlerësoni me numër nga zero e lartë, Rretho numrin)					
0 Pakënaqur	1 I kënaqur	2 Mesatarisht	3 Mirë	4 Plotësisht i kënaqur	
26. Sa jeni te kënaqur me bashkëpunimin mësimdhënës nxënës? (vlerësoni me numër nga zero e lartë, Rretho numrin)					
0 Pakënaqur	1 I kënaqur	2 Mesatarisht	3 Mitë	4 Plotësisht i kënaqur	
27. Sa ju përkrahin mësimdhënësit? (vlerësoni me numër nga zero e lartë, Rretho numrin)					
0 Aspak	1 Shume pak	2 Mesatarisht	3. Shume		
28. Sa kenimirëkuptim nga mësimdhënësit në zgjidhjen e ndonjë halli tuaj? (vlerësoni me numër nga zero e lartë, Rretho numrin)					
0 Aspak	1 Shume pak	2 Mesatarisht	3 Shume		
29. Sa informojnë mësimdhënësit apo organet e shkollës prindërit apo familjen tuaj për suksesin apo ndonjë problem tuajin në shkollë? (vlerësoni me numër nga zero e lartë, Rretho numrin)					
0 Aspak	1 Shume pak	2 Mesatarisht	3 Shume		
30. Cilët nga këta faktorë jo-akademik ndikojnë ne suksesin tuaj?(Rrethofjalën/fjalinë)					
Puna jashtë shkollës		Çështjet financiare	Obligimet familjare	Shëndeti fizik	
31. A keni ndonjë përgjegjësi jashtë procesit mësimor qe ndikon ne suksesin tuaj?(Rrethofjalën/fjalinë)					
1 Nuk kam asnjë përgjegjësi jashtë shkollës					
2 Punoj çdo ditë					
3 Jam ne praktike (zanat)					
4 Kujdesem për familjarë/t					
32. Nevojat financiare për në shkollë (mjetet shkollore, librat, udhëtimin, ushqimi në shkollë dhe harxhime të tjera), i siguroj nga (Rrethofjalën/fjalinë)					

1 puna vetanake	2 prindërit	3 familjarë të tjerë	4 burime të tjera jashtë familjes
Ju faleminderit për kohën dhe konsideratën tuaj.!			